




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



05.11.2019

01.Nr.104/02-35424/19

Në mbështetje të nenit 13 dhe 17 të Ligjit Nr.03/L-40- për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe pas përgjigjes në kërkesë nga Agjencioni Kundër Korrupsionit me nr. AKK-DPKI-06-02-1838/19, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

**PËR NDRYSHIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E
PROCEDURAVE TË ANKANDIT PUBLIK**

1. Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet pika 1, shkronja b dhe c, e Vendimit 01.Nr-104/02-26732/19, lirohen nga Komisioni Arsim Zenuni dhe Festim Neziraj, zëvendësohen me Besnik Bajra dhe Rufki Zharku.
2. Besnik Bajra dhe Rufki Zharku , në bashkëpunim të ndërsjellë, obligohen t'i zhvillojnë procedurat e ankandit publik konform Vendimit 01.Nr-104/02-26732/19 të datës 19.08.2019.

A r s y e t i m:

Me deklarimin e Arsim Zenuni, pas marrjes të Vendimit se veprimtaria në këtë komision mund të shpërfaqte konflikt të interesit, zyra e kryetarit, nëpërmjet drejtorisë së administratës së përgjithshme ka bërë kërkesë në AKK për sqarim të qështjes. Pas kthimit të përgjigjes me nr. AKK-DPKI-06-02-1838/19, që në këtë rast nuk shpjegohet qartazi se paraqet apo jo konflikt interesi angazhimi i tij, Kryetari i Komunes ka ndërmarrë masat preventive që të parandaloj çdo situatë ku mund të hasim në konflikt interesi. Gjithashtu, zëvendësohet Festim Neziraj me Rufki Zharkun për arsye se ky i fundit, është përgjegjës i autoparkut dhe njeh shumë mirë gjendjen e veturave të cilat parashihet të shiten. Duke u bazuar në këto të dhëna është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen:

Anëtarët e Komisionit;

Besnik Bajra (edhe me Vendimin 01.Nr-104/02-26732/19)

Rufki Zharku (edhe me Vendimin 01.Nr-104/02-26732/19)

Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Data: 08.11.2019



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik
01.Nr. 104/02-35905/19

Në bazë të Statutit të Komunës së Kaçanikut, në bazë të nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040, merr:

VENDIM

I

Me këtë vendim formohet komisioni 5 anëtarësh, për shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesën 06-104/02-35113/19, të bërë nga “2 korriku” Sh.P.K me përfaqësues Ejup Kovaçin, lidhur me kërkesën e tij për rritje të kapacitetit.

Komisioni përbëhet prej:

- 1-Hajredin Shehu, Zyrtar në DESHP
- 2-Nebih Murseli, Zyrtar në DESHP
- 3-Hamzë Berisha, Zyrtar në DUKMM
- 4-Rufat Muqa, Zyrtar në DUKMM
- 5- Visar Mulaku, Zyrtar në DUKMM

II

Komisioni ka të drejtë të ketë qasje në të gjithë dokumentacionin e nevojshëm rreth kësaj lënde në DUKMM, duke marrë parasysh Lejen e Ndërtimit të cilën tashmë e posedon “2 korriku” Sh.P.K. si dhe të gjitha kërkesat e parashtruara deri tash nga kjo shoqëri.

III

Komisioni të vendos brenda afatit ligjor të kërkesës.

Kryetari i Komunës,
Besim Haxhi